



**Drejtuar: Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk**

**Adresa: Njësia Bashkiake Nr. 5, Rr:“Ibrahim Rugova”, pranë gardës së Republikës, Pallati “Kontakt”, mbi Union Bank, Tiranë.**

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rikualifikim urban i bllokut qe kufizohet nga Blv Bajram Curri-Blv Petro N. Luarasi-Rruga Taulantia-Rruga Ali Demi-Faza I”**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikualifikim urban i bllokut qe kufizohet nga Blv Bajram Curri-Blv Petro N. Luarasi-Rruga Taulantia-Rruga Ali Demi-Faza I”.**

**Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-17117-04-08-2019**

**Fondi limit: 112,518,191** (njëqind e dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2019, miratuar me VKB Nr. 159, datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 08.07.2019, ora 12:00**

**Publikime të mëparshme:** (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 15 datë 15.06.2019.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “Curri” shpk**

NUIS

J67902718S

Vlera e ofertës = **86,034,320.50** (tetëdhjetë e gjashtë milion e tridhjetë e katër mijë e treqind e njëzetë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

## 2. Operatori ekonomik “Senka” shpk

NUIS

J94808405Q

Vlera e ofertës = **89,396,045** (tetëdhjetë e nëntë milion e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH.

## 3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk &”EuroAlb” shpk

NUIS K51501008J & NUIS K66613407H

Vlera e ofertës = **90,292,333** (nëntëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e dy mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

## 4. Operatori ekonomik “Gjikuria” shpk

NUIS J62903456H

Vlera e ofertës = **94,900,888** (nëntëdhjetë e katër milion e nëntëqind mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

## 1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Curri” shpk

NUIS J67902718S

- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 5 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë/1 (një) inxhinier Ndërtimi (Profili Transport)”* pasi Inxhinieri Kol Dedaj i deklaruar si inxhinieri ndërtimi profili transport nga verifikimi i diplomës rezulton inxhinier ndërtimi për rrugë-ura-vepra nëntokësore. gjithashtu Kontrata e punës daton në 10.11.2018 dhe figuron në listapagesa vetëm 5 muajt e fundit dhe jo 6 muajt e fundit të kërkuar.
- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 7 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë/2 (dy) punonjës hidraulik (Kategoria II)”* pasi Nga 2 (dy) hidraulikë kategoria II të kërkuar është paraqitur vetëm 1 punonjës hidraulik me këtë kategori si dhe nuk janë paraqitur diplomat.
- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 7 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar*

*punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë/2 (dy) punonjës elektrikist (Kategoria II)” pasi nga 2(dy) elektrikistë kategoria II të këruar është paraqitur vetëm një elektrikist me këtë kategori si dhe nuk janë paraqitur diplomat.*

- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 7 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë/1 (një) punonjës teknik ndërtimi (Kategoria IV)”* pasi Tekniku i Ndërtimi është kategoria III dhe jo kategoria IV e kërkuar.
- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) Eskavatorist, 1 (një) Buldozerist, 2 (dy) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme)....”* pasi Nuk është paraqitur dokumentacion për 1 (një) buldozerist.
- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/Kamioncina 3,5-5 ton”* pasi Kamioncinat nën kapacitetin 3,5-5 ton, konkretisht kamioncina me targë AA653 HA=1,2 ton, targë AA395OS=0,9 ton, targë AA179OL=1,3 ton, targë AA244UC=1,05 ton, targë AA455RK=0,9 ton, targë AA644LB=0,85 ton, targë AA578BD=0,97 ton ndërsa për kamioncinat me marra me qera me targë AA918HP dhe AA169SK nuk është paraqitur dokumentacion.
- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/Autobitumatrice”* pasi Ka deklaruar mjetin Autobitumatrice (shpërndarës bitumi) për të cilën ka paraqitur vetëm faturë tatimore dhe asnjë dokumentacion të kërkuar dhe ka deklaruar sit ë marrë me qera mjetin Autobitumatrice me targë LU3021C për të cilin nuk është paraqitur asnjë dokumentacion.

## **2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Senka” shpk**

**NUIS J94808405Q**

- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson pikën 1 të kritreve të përgjithshme të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8”* pasi kjo deklaratë nuk është paraqitur sipas formatit të përcaktuar në DST.
- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson pikën 5 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më*

*poshtë/1 (një) inxhinier Ndërtimi (Profili Transport)*” pasi nuk ka paraqitur Inxhinier Ndërtimi Profili Transport.

- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson pikën 7 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë/1 (një) punonjës teknik ndërtimi (Kategoria IV)”* pasi Tekniku i Ndërtimi është kategoria II dhe jo kategoria IV e kërkuar.
- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson gërmën “f” të pikës 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohej dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi)”* pasi Nuk është paraqitur Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohej dhe **vendndodhja e mjeteve** në pronësi ose me qera me qellim verifikimi.
- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi për mjetet me targë AA718RO dhe AA546BZ leja e qarkullimit është paraqitur fotokopje e pashoqëruar me vërtetimin e noterizimit ndërsa për kamionin me targë AA236NG I gjithë dokumentacioni është paraqitur fotokopje I pa shoqëruar me vërtetimin e njëhësimin të kopjes me origjinalin cka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST ku: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për ‘skualifikim’”*.
- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi për mjetet Autobetoniere me targë TR1485N, TR2516M, TR5957K lejet e qarkullimit dhe certifikatat për transport mallrash brenda vendit janë paraqitur fotokopje të pashoqëruar me vërtetimin e njëhësimin të kopjes me origjinalin cka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST ku: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s’kualifikim”*.

### **3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Sireta 2F” shpk & “EuroAlb” shpk**

**NUIS K51501008J & NUIS**

**K66613407H**

- Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk nuk plotëson pikën 2 të kapacitetit e ekonomik dhe financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit ushtrimore (2016, 2017, 2018) lëshuar nga*

autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se 50% e vlerës së fondit limit perkatesisht: **56,259,096** (pesëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH” pasi nuk ka paraqitur vërtetimin për xhiron vjetore për vitet 2016,2017,2018.

- Operatori ekonomik “EuroAlb” shpk nuk plotëson pikën 1 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën”* pasi kontratat e paraqitura nuk janë punë të ngjashme.
- Operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk nuk plotëson pikën 6 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm”* për mjeken e deklaruar ka paraqitur diplomë, urdhër mjeku dhe librezë e punës fotokopje e pashoqëruar me Aktin e Noterizimit cka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST ku: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për ‘skualifikim’.*
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk &”EuroAlb” shpk nuk plotëson pikën 7 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë/pasi janë deklaruar katër punonjës teknikë ndërtimi për të cilët rezulton si më poshtë: Për punonjësit me iniciale D.M, E.M, E.F, dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik rezulton e kategorisë II, si dhe për këta punonjës nuk është paraqitur diploma përkatëse. Ndërsa për punonjësin me iniciale P.M, dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik rezulton e kategorisë II.*
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk &”EuroAlb” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi nuk është deklaruar asnjë kamion me kapacitet mbajtës 10 ton-15 ton.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk &”EuroAlb” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi është deklaruar vetëm një kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 ton-5 ton përkatësisht me targë TR3893 për të cilën nuk është paraqitur çertifikatë pronësie.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk &”EuroAlb” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi është deklaruar një autobetoniere tip MOD DH691 për të cilën nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar në DST, por thjesht është shoqëruar me një faturë.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk &”EuroAlb” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për*

*mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*” pasi është deklaruar një autobot uji përkatësisht me targë TR9540S, për të cilin nuk është paraqitur Çertifikata për transport mallrash brenda vendit.

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk &”EuroAlb” shpk nuk plotëson pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*” pasi është deklaruar 3 autovinçë përkatësisht me targë AA735PY, AA698MZ, AA798CP. Asnjë nga kamionët e sipërcituar nuk plotëson tonazhin e kërkuar në DST prej 5 ton pasi mjeti me targë AA735PY ka kapacitet mbajtës 11.9 ton, mjeti me targë AA698MZ ka kapacitet mbajtës 3.1 ton ndërsa mjeti me targë AA798CP ka kapacitet mbajtës 6.6 ton.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatori ekonomik “Gjiguria” shpk**, me adresë: **Njësia Bashkiake Nr. 5, Rr:“Ibrahim Rugova”, pranë gardës së Republikës, Pallati “Kontakt”, mbi Union Bank, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **94,900,888** (nëntëdhjetë e katër million e nëntëqind mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 09.08.2019.**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.